



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1407/4 prot.

Vlorë, më 19.11.2018

VENDIM

Nr. 76, datë 19.11.2018

**PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT
"MASTER PROFESIONAL NË UDHËRRËFIM DHE KOMUNIKIM TURISTIK"**

Mbështetur në nenin 75, pikën 7 të nenit 25, shkronjën **dh**, pika 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 31, datë 29.12. 2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 19.11.2018

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Gjuhëve të Huaja për program të ri studimi të ciklit të dytë "Master profesional në udhërrëfim dhe komunikim turistik".
2. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

